



## Grupi Punues për çështje tregtare dhe barriera tregtare – KKZHE

E mërkurë, 24 Prill 2019 10:00

### Qëllimi & Mandati

Qëllimi i këtij grupi është që t'ia mundësojnë sektorit privat që përmes këtyre mekanizmave t'i adresojnë të gjitha ato barriera me të cilat ata ballafaqohen qofshin ato probleme teknike, administrative, ligjore, fiskale si dhe barrierat jo-tarifore dhe ato teknike tregtare të aplikuara nga vendet e CEFTA-së dhe të tjerat, ndaj kompanive eksportuese kosovare.

Problemet e identifikuara nëpër këto takime adresohen përmes këtyre nën-grupeve punuese tek institucionet përgjegjëse me qëllim të zgjidhjes së tyre. Deri më tani këto grupe punuese janë treguar mjaft të suksesshme duke zgjidhur disa raste të adresuara përmes këtij mekanizmi. Çështjet të cilat nuk kanë arritur të zgjidhen përmes këtij grupi apo nëngrupeve punuese janë ngritur dhe diskutuar në Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës.

Me këtë rast KKZHE vendos që ky grup ta ruaj përbërjen e tanishme dhe i njëjti mekanizëm të shfrytëzohet edhe me tutje, por duke u fuqizuar nën ombrellën e KKZHE-së.

### Përbërja e Grupit (varesisht nga nevoja)

- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – kryesues
- Ministria e Punëve të Jashtme
- Ministria Financave
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Ministria e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
- Administrata Tatimore e Kosovës
- Doganat e Kosovës
- Përfaqësuesit e Sektorit Privat.

### Punën e grupit do ta udhëheqë Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (apo personi i deleguar).

Grupi do të ketë Sekretariatit teknik (nga stafi aktual), që do të udhëhiqet nga Departamenti i Tregtisë së MTI-së në bashkëpunim me Departamentin e Industrisë, i cili do të përgatis temat dhe materialet për diskutim të Grupit. Ky sekretariat do të bashkëpunojë ngushtë me sekretariatit e KKZHE-së.

Departamenti i Tregtisë i MTI-së do të dorëzoj raporte të rregullta në lidhje me barrierat me të cilat ballafaqohen bizneset.

**Në raste të veçanta, Grupi mund t'i paraqes propozimet dhe rekomandimet e veta tek KKZHE.**

